

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“KapitalX_AL” SH.P.K

Sot, me date 01.06.2025 (dymije e njezet e pese) te nenshkruarit:

1. **Shoqëria Kapital X sh.p.k** e themeluar me 15 janar 2013 ne Prishtine Republika e Kosoves, me nr unik 810 822 719. Me adrese 10000 Prishtine Rr Holger Pedersen1/7 Republika e Kosoves. E perfaqesuar nga administartori i saj Z. Valdet Xoxa identifikuar me nr personal 1004105008.
2. **Shtetasi Ervis Jaho** i biri i Qetësorit dhe Drita i dtl 24.05.1985, lindur në Kolonjë banues Tiranë Rr “Besim Memaci”, Banesë private Tiranë identifikuar me nr personal I50524055Q.

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ‘Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare’ dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, redaktojme këtë Akt Themelimi për themelimin e shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“Kapitalx_AL” SH.P.K**, me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Ortaket themelues te shoqerise jane, **shoqëria Kapital X sh.p.k** , dhe **shtetasi Ervis jaho**

Neni 2

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **“KAPITALX_AL” SH.P.K.**

Neni 3

Shoqëria e ka seline e saj ne adresen: Rr ‘Shefqet Ndroqi’, nr 11/13 Tiranë.


Perveç ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakeve te Asamblese se Përgjithshme.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë



Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Punime ne fushen e ndertimeve dhe projekteve, ndertime objekte banimi dhe jobanimi, ndertim i rrugeve dhe autostradave, ndertimi i hekurudha mbi dhe nentokesore, ndetimi i urave dhe tuneleve, hartimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve, hartimi projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikacion, hartimi projekteve të ujit, hartimi i projekteve të tjera të ndertimit civil, demolimi i objekteve, instalime elektrike, punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit, instalime të tjera ndertimore, punime suvatimi, punime montimi druri dhe materialeve të tjera, punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve, punime lysterje dhe vendosje xhamamsh, përfundim dhe finalizimin e punëve të tjera të ndertesave, punimet të çatise, aktivitete të tjera të specializuara në ndertim, ndërmjetësim për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të tjera të ndertimit, ndërmjetësim për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash, tregëti me shumicë e drurit, materialet të ndertimit dhe pajisjeve hidrosanitare, tregëti me shumicë e pjesëve elektronike, pajisje hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit, tregëti me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme, blerja dhe shitja e pasurive të patundshme, Qiradhenia dhe menaxhimi i pasurive të patundshme personale ose të marra me qera, administrimi i ndërmarrjeve për të trete, aktivitete të arkitektures, aktivitete të inxhinierisë dhe këshillimit teknik.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Ortave të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (qëndmijë) lekë të zotëruar prej ortakëve, si më poshtë:

Emri	Përqindja	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Shoqëria Kapitalx sh.p.k	51%	1	51.000 lekë
Ervis Jaho	49%	1	49.000 lekë

Kapitali themeltar është nënshkruar krejtësisht nga ortakët themelues dhe pjesa në vlerë do të depozitohet në llogarinë e posaçme të shoqërisë mbas fitimit të personalitetit të saj dhe hapjes së llogarive në banka në emër të saj.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimit të Ortave të Asamblesë së Përgjithshme, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar. si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 7

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator.

Administrator i shoqerise eshte Z. **Ervis Jaho** me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili do te ushtroje detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riprteritje, duke filluar nga data 01.06.2025 deri me 31.05.2030. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata per shkeje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj

Ortaku Ervis Jaho do të kryejë menxhimin e përditshëm të shoqërisë dhe drejtimin financiar si dhe do të menaxhojë marrëveshjet me furnitorët vendas.

Ortaku shoqëria Kapital X sh.p.k do të meret me pjesën e marketingut shitjes rrjetit të klientëve si dhe do menaxhojë marrëveshjet me furnitorët ndërkombëtar.

Ortakët do te zhvillojne takime javore ne fund te javes për ti përditsuar të dhënat e njeri tjetrit.

Neni 8

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si dhe në bazë të Statutit dhe këtij Akti Themelimi. Neni 14

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje to gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

e)krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

f)kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

g)raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi to vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve to ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave to shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit to zakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo to huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per to kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave to Punes, Autoriteteve Doganore etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne pcrputhje me objektin e saj.

Dispozita e fundit

Ky akt themelimi është perpiluar në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

Ortakët, pasi lexojnë dhe kuptojnë përmbajtjen e këtij Akt Themelimi, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë nënshkruajnë si më poshtë.

ORTAKET THEMELUES

“Kapitalx_AL”sh.p.k

Ervis Jaho

Shoqëria Kapitalx sh.p.k

Administratori Valdet Xoxa

